



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.03.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtim i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi – Shqipëri, alokimet e vitit 2017”

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Xhemal Qefalia, Elena Xhina, Sadi Vorpsi, Luan Duzha, Anduel Xhindi, Pjerin Ndreu, Myslym Murrizi, Luan Harusha, Milva Ekonomi dhe Adnor Shameti.

Mungojnë:

Elona Hoxha, Paulin Sterkaj, Ylli Shehu dhe Antoneta Dhima

Të ftuar:

Danjela Çekani- Drejtore e Fondeve IPA

Iris Kruja- Përgjegjëse e Sektorit të Politikave Ekonomike

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj- Mirëdita!

Hapim mbledhjen e radhës të komisionit.

Sot në rendin e ditës së komisionit kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi – Shqipëri, alokimet e vitit 2017”

Kjo marrëveshje, sa i përket formatit, është e njëjtë me ato që kemi kaluar edhe herë të tjera si Komision Sigurie.

Për të prezantuar këtë marrëveshje kemi prezent përfaqësuesen e Ministrisë së Jashtme, zonjën Danjela Çekani.

Në fakt, prezent do të ishte edhe zëvendësministri i Jashtëm, por na kanë kërkuar ndjesë për faktin që është kërkuar në Kryeministri.

Relator i marrëveshjes është zoti Harusha.

Fjalën e ka zonja Çekani, për të na bërë një prezantim të përgjithshëm të kësaj marrëveshjeje.

Danjela Çekani – Faleminderit!

Ashtu siç e përmendët dhe ju, ratifikimi i kësaj marrëveshjeje financimi në kuadër të programit të bashkëpunimit ndërkufitar IPAAII, Mali i Zi dhe Shqipëri, është në vazhden e marrëveshjeve të tjera që ne kemi ratifikuar në kuadër të këtij programi, por kjo marrëveshje specifikon alokimet e vitit 2017.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje financimi do të mundësojë zbatimin e përbashkët të projekteve nga të dyja vendet pjesëmarrëse në këtë program, duke sjellë mundësinë e bashkëpunimit, shkëmbimin e përvojave pozitive të të dyja vendeve, si dhe një kontribut dhe impakt të matshëm sa i takon nivelit socio-ekonomik të të dy vendeve.

Alokimet e vitit 2017, ashtu sikurse edhe të viteve të tjera paraardhëse, financohen nga një grant i BE-së, i cili, sa i takon vitit 2017, arrin në vlerën 1 milion e 190 mijë euro, duke përfshirë këtu edhe bashkëfinancimin me një vlerë prej 210 mijë eurosh, si kontribut i përbashkët midis dy vendeve, të gjitha bashkë arrijnë në një vlerë totale prej 1 milion e 400 mijë eurosh. Sikurse e kemi përmendur edhe me parë, janë 3 prioritete kryesore në të cilat ky program mbështetet dhe të

gjithë përfituesit në nivel qendror dhe vendor do të kenë mundësi të paraqesin projektpropozimet në kuadër të thirrjes së dytë që do të financohet me alokimet e vitit 2017. Aktualisht, programi e ka përmbyllur tashmë thirrjen e parë për projektpropozime, thirrja e dytë do të fokusohet në 2 prioritete nga 3 në total, që kanë lidhje me nxitjen e punësimit dhe me mbrojtjen mjedisit.

Në Shqipëri zonat e lejueshme dhe përfituese të programit janë rrethi i Shkodrës, Lezhës dhe Tropojës. Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme me qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e kushteve për projektaplikime të suksesshme ka planifikuar dy sesione informimi, përkatësisht në datat 4 dhe 5 prill në Shkodër dhe në Lezhë, për të ndihmuar dhe asistuar të gjithë përfituesit e mundshëm, për t'u njohur më konkretisht me rregullat, procedurat dhe teknikalitetet e tjera dhe për të lehtësuar partneritetet e tyre, me qëllim vijueshmërinë e suksesshme të procesit të aplikimeve.

Deri në datën 27 maj, i cili është edhe afati i fundit i përcjelljes së projektpropozimeve, ministria, në rolin e saj si koordinator kombëtar i këtyre fondeve, do të asistojë të gjithë të interesuarit në raport me këtë program.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Zonja Çekani, është drejtoreshë e fondeve IPA. Nëse keni pyetje edhe në përgjithësi për mënyrën si lëvrohen dhe përdoren këto fonde, mund t'ia drejtoni.

Fjalën e ka zoti Harusha.

Luan Harusha- Faleminderit!

Qëllimi i kësaj marrëveshje është të kontribuojë për zhvillimin social-ekonomik të zonave ndërkufitare dhe do të rritë bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve, përmes ndërhyrjeve të përbashkëta.

Programi do të fokusohet në disa pika: nxitjen e turizmit dhe trashëgiminë kulturore e natyrore; mbrojtjen e mjedisit; nxitjen e përshtatjes dhe të lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimin dhe menaxhimin e rrezikut; nxitjen e punësimit; lëvizjen gjeografike të punonjësve dhe të përfshirjes socialo-kulturore përtej kufijve. Përfitues të këtij programi do të jenë Mali i Zi dhe Shqipëria. Në Malin e Zi do të jetë zona e Plavës, Gucisë, Podgoricës, Danilovgradit, Budvës, Barit dhe Ulqinit, ndërsa në Shqipërisë do të jenë zona e Shkodrës, Lezhës dhe rrethi i Tropojës. Mali i Zi dhe Shqipëria do të bashkëpunojnë ngushtë me njëri-tjetrin për koordinimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen për zbatimin e programit dhe të strukturës institucionale. Programi është i përbërë

nga autoritetet kontraktuese të Malit të Zi. Komisioni i përbashkët monitoron sekretarin teknik të përbashkët, si dhe koordinatorin ndërkombëtar të Fondit IPA të të dyja vendeve përfituese.

Nisur nga ato që thashë më lartë i ftoj anëtarët e komisionit ta miratojnë projektin në parim, nen për nen dhe në tërësi.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Harusha!

A ka pyetje nga kolegët? Nuk ka.

Atëherë, po ju bëj unë dy pyetje para se të kalojmë në votimin e kësaj marrëveshjeje. Zonja Çekani, ju keni një përvojë të gjatë sa i takon përdorimit të fondeve IPA. Në gjykimin tuaj, sa kanë ndikuar këto në lehtësimin e problematikave në sektorë të ndryshëm? A mund të kemi sot një analizë të plotë të impaktit që këto fonde kanë sjellë në këtë sektor, e disponon këtë gjë Ministria e Jashtme?

Faleminderit!

Daniela Çekani – Faleminderit për pyetjet!

Aktualisht Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme është në bashkëpunim të ngushtë me delegacionin e Bashkimit European, për të siguruar të dhëna financiare që bëjnë të mundur pikërisht vlerësimin e impaktit që këto projekte kanë dhënë jo vetëm në Shqipëri, por në përgjithësi për gjithë rajonin. E them këtë, pasi gjatë periudhës 2007-2013, autoritet kontraktor për këto projekte ka qenë delegacioni i Bashkimit European dhe autoritetet kombëtare, sikurse janë Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme monitorojnë zbatimin e projektit nga pikëpamja përmbajtësore të arritjes së objektivave dhe të indikatorëve të vendosur në projekt-propozimet përkatëse, ndërkohë që menaxhimin financiar e bën Autoriteti Kontraktor.

Ne tashmë i disponojmë këto të dhëna pas një periudhe të gjatë diskutimi dhe konsultimi me ta, por duhet të keni parasysh se periudha e programit nga ajo e zbatimit ka një diferencë prej 3 vjetësh. Ne aktualisht jemi angazhuar në një proces vlerësimi sa i takon rolit tonë, por gjithsesi mbetemi modest, pasi vlerësimi i impaktit do të bëhet me ekspertizë nga Komisioni European. Vlerësimi bëhet në total për gjithë rajonin, duke qenë se këto programe dhe projekte implementohen bashkërisht nga përfituesit e të dy vendeve dhe është shumë e vështirë të ndash nivelin e impaktit nga njëra anë e territorit dhe jo nga tjetra.

Aktualisht, disponojmë të dhëna fillestare, të cilat na lejojnë të bëjmë një interpretim të përgjithshëm lidhur me disbursimin e fondeve IPA jo vetëm të marrëdhënieve të bashkëpunimit

ndërkufitar dhe transnacional, por edhe të IPA-s, që ne e quajmë IPA Kombëtare, ajo që shkon nëpërmjet mbështetjes buxhetore sektoriale në sektorë të ndryshëm të qeverisë, por kjo i takon periudhës 2014-2020.

Ne jemi angazhuar që së bashku me një asistencë teknike, e cila tashmë ka filluar të funksionojë dhe asiston në Ministrinë për Europën të bëjmë një vlerësim më të detajuar në dakordësi edhe me Bashkimin European, edhe në përputhje me marrëveshjen kuadër në të cilën jemi pjesë. Ne jemi duke finalizuar modalitetet dhe besoj se shumë shpejt do të kemi mundësinë të bëjmë një interpretim më të saktë të vlerësimit, jo vetëm të përthithshmërisë së këtyre fondeve, por edhe të impaktit në sektorë të ndryshëm. Jemi ende në fazat e hershme, disponojmë një raport fillestar, të cilin e kemi ndarë edhe me institucione të tjera, por siç ua përmenda është pak e vështirë gjenerimi i të dhënave vetëm për Shqipërinë, duke i ndarë me ato të rajonit, sepse ka bashkëpunim me shumë aktorë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – A ka filluar aplikimi për IPA III?

Daniela Çekani – Jo, nuk ka filluar, pasi këtë vit do të bëhet konsultimi me të gjitha institucionet kombëtare dhe jo vetëm. Komisioni European ka planifikuar të zhvillojë një set diskutimesh dhe aktualisht janë vendosur vetëm prioritetet tematike që ne nuk i kemi diskutuar, sepse janë të shumta, por do të merret edhe mendimi i Autoriteteve Kombëtare për qasjen e re që Bashkimi European synon të sjellë për të gjitha vendet e rajonit. Konsultimi nuk ka nisur ende, e di merakun tuaj...

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Unë prandaj ju pyeta dhe shpresoj ta keni në vëmendje atë çfarë ne kemi dashur të tërheqim edhe si sugjerim nga ju.

Daniela Çekani – Ne do t'ju informojmë në vijim.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Kalojmë në miratimin në parim të këtij projektligji. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet projektligji në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen të projektligjit.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me ratifikimin në tërësi me marrëveshjen “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi – Shqipëri, alokimet e vitit 2017””? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Falënderoj dy përfaqësuesit e Ministrisë së Jashtme!

Këtu mbyllet mbledhja për ditën e sotme.

MBYLLET MBLEDHJA